



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

---

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_/\_\_\_/2019

## V E N D I M

**Nr. 89, Datë 08/07/2019**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 71, datë 20.06.2019, e Z. A. H., ku pretendohet diskriminim për shkak të “*moshës*” dhe “*përkatësisë në një grup të veçantë*”, nga ana e Universitetit Politeknik të Tiranës dhe nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë,

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, Komisioneri,

### K O N S T A T O I:

#### **I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Mbështetur në informacionin që përmban formulari i ankesës, si dhe referuar dokumentacionit bashkëlidhur, rezulton se Z. A. H., i lindur në Lushnjë në datën 25.02.1952, ka fituar titullin “Profesor i Asociuar”, vitin 2000, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës dhe për 10 vite rradhazi ka punuar në vijim për të fituar titullin “Profesor”, sipas kriterëve dhe kërkesave të parashikuara në Vendimin nr. 467, datë 18.07.2007, e Këshillit të Ministrave<sup>1</sup>, “*Për përcaktimin*

---

<sup>1</sup> Aktualisht i shfuqizuar nëpërmjet Vendimit nr.112, datë 23.02.2018, të Këshillit të Ministrave “*Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i asociuar” dhe “Profesor”.*”

*e kriterëve dhe të procedurave për kualifikimin, shkencor e pedagogjik, të personelit akademik”* (i ndryshuar). Për sa më sipër, ankuesi sqaron se ka depozituar dosjen e tij pranë Universitetit Politeknik të Tiranës, në shtator të vitit 2014, por Këshilli i Profesorëve, të FIM vendosi të mos procedojë me dosjen në fjalë, me pretendimin se dosja kishte mangësi, fakt që nuk pranohet nga ankuesi, i cili një gjë të tillë e konsideron keqdashje. Për të sqaruar faktin e mësipërm, ankuesi pretendon se ka dërguar pranë Këshillit të Profesorëve, një ankesë me shkrim, në datën 18.11.2015, për të cilën nuk i është dërguar përgjigje zyrtare.

Në vijim, pas ndryshimit të titullarëve të Universitetit Politeknik të Tiranës, ankuesi informon se e ka depozituar sërish dosjen e tij, përkatësisht në datën 07.06.2016. Dosja e ankuesit është regjistruar me nr. 168, datë 20.06.2016. Këshilli i Profesorëve të FIN, sërish nuk e mori në shqyrtim dosjen e tij, me justifikimin se nuk kishte kohë që të mbyllej procesi, por ankuesi pretendon sërish se ka keqdashësi. Për sa më sipër, Z.A. H. pretendon se, në kushtet kur, dosje të tjera që janë depozituar pranë Këshillit të Profesorëve janë shqyrtuar, ai diskriminohet, për shkak të ankesës ka bërë në vitin 2015, si dhe për shkak të moshës së tij.

Pretendimi i tij për diskriminim qëndron edhe ndaj parashikimit të pikës 7, të Dispozitave Kalimtare, të Vendimit nr.112, datë 23.02.2018, të Këshillit të Ministrave, *“Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i asociuar” dhe “Profesor””, ku parashikohet: “Kandidatët, të cilët kanë filluar procedurën për marrjen e titujve akademikë dhe kanë kaluar fazën e miratimit nga Këshilli i Profesorëve, e mbyllin procedurën për marrjen e titullit akademik, sipas kriterëve të legjislacionit në fuqi, në momentin e dorëzimit të dosjes në Këshillin e Profesorëve. Këta kandidatë ndjekin procedurat e përcaktuara në këtë vendim, për fazën përfundimtare në Komisionin për Promovimin e Personelit Akademik”*. Për sa më sipër, ankuesi shprehet se ai e ka depozituar dosjen pranë Këshillit të Profesorëve dhe ky i fundit nuk e ka marrë në shqyrtim. Në këtë kontekst, ai pretendon se diskriminohet nga parashikimi i dispozitës së mësipërme.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin paraprak të ankesës nga Komisioneri.**

Për efekt të administrimit të informacionit të mëtejshëm, në lidhje me ankesën nr. 71, datë 20.06.2019, e Z. A. H., Komisioneri i dërgoi ankuesit njoftim për paraqitje në takim<sup>2</sup>, i cili u zhvillua në datën 27.06.2019.

---

<sup>2</sup> Njoftimi u krye nëpërmjet postës elektronike, në datën 26.06.2019.

Në këtë takim, në referencë të e-mailit të dërguar, Z.A. H. depozitoi pranë Komisionerit dokumnetacionin e kërkuar, që konsistonte në korrespondencën zyrtare me Universitetin Teknik të Tiranës, Ministrinë e Arsimit, Sportit e Rinisë, kopje të diplomave të titujve të fituar etj.

Lidhur me pretendimin e tij për ndryshimin e pikës 7, të Dispozitave Kalimtare të Vendimit nr.112, datë 23.02.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i asociuar” dhe “Profesor””, ankuesi u shpreh se në të, duhej shtuar parashikimi edhe për ata kandidatë, të cilët i kanë depozituar dhe regjistruar me protokoll dosjet e tyre pranë Këshillit të Profesorëve, por që ky i fundit nuk i ka marrë ende në shqyrtim.

#### **A. Konstatimet e Komisionerit pas analizimit paraprak të ankesës nr. 71, datë 20.06.2019, e Z. A. H..**

Pas kryerjes së analizimit paraprak të ankesës nr. 71, datë 20.06.2019, e Z. A. H., Komisioneri konstatoi, si vijon:

1. Pretendimi i parë i Z.A. H. konsiston në diskriminim, për shkak të moshës, nga Universiteti Politeknik të Tiranës.

Në bazë të informacionit të administruar rezulton se Z.A. H. ka fituar titullin “Profesor i Asociuar” në vitin 2000<sup>3</sup>. Në vijim, ankuesi ka punuar për të fituar titullin akademik “Profesor” dhe ka depozituar dosjen e tij, për t’u shqyrtuar nga Këshilli i Profesorëve, në vitin 2014. Këshilli i Profesorëve ka dalë me Vendimin nr. 11, datë 27.05.2015, ku pasi janë kryer konstatimet përkatëse, është vendosur që kërkesa e ankuesit të mos miratohet e të mos vazhdojë më tej procedura e marrjes së titullit të kërkuar. Në këtë Vendim është vendosur, që dosja e ankuesit, t’i kthehet Drejtorisë së Kërkimit Shkencor në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës.

Pas plotësimit të mangësive të konstatuara, në vitin 2016, ankuesi A. H. e ka depozituar sërish dosjen e tij, pranë Këshillit të Profesorëve. Dosja e tij rezulton e regjistruar me nr. 168, datë 20.06.2019<sup>4</sup>, Që prej kësaj kohe, ankuesi nuk rezulton të ketë korrespondencë zyrtare me UPT-në. Data 20.06.2016 përkon me momentin e ndodhjes së diskriminimit të pretenduar nga ankuesi, në referencë të shënimeve të tij, në formularin e ankesës. Për sa më sipër, Komisioneri konstaton

---

<sup>3</sup> Referuar Dëshmisë Nr. Rregj. Themeltar 4533, Nr. Dëshmisë 49, datë 11.09.2000, të lëshuar nga Komisioni i Kualifikimit Shkencor, pranë Këshillit të Ministrave;

<sup>4</sup> Referuar vertetimit nr. 19/6, datë 29.06.2019, të lëshuar nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, pranë UPT-së.

se kjo datë rezulton të jetë edhe momenti i marrjes dijani për diskriminimin e pretenduar nga ana e ankuesit, pasi nuk rezultojnë prova të tjera, që të vërtetojnë të kundërtën. Ndërkohë që, data e regjistrimit të ankesës së Z. A. H., pranë Komisionerit, është **20.06.2019**.

Në nenin 33, pika 4, gërma dh), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” parashikohet se ankesa nuk pranohet, nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se një vit nga marrja dijani nga i dëmtuari, për këtë fakt.

Në këtë kontekst, rezulton se ankuesi e ka depozituar ankesën e tij, 3 vjet, nga momenti i ndodhjes së diskriminimit, si dhe më vonë se 1 vit nga marrja dijani për diskriminimin e pretenduar.

Në këto kushte Komisioneri gjykon se ankesa e Z.A. H. është depozituar tej afateve ligjore të përcaktuara nga nenin 33, pika 4, gërma dh), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe ndodhet në pamundësi për të shqyrtuar pretendimin e parë të tij, të parashtruar në ankesën nr. 71, datë 20.06.2019.

Për sa më sipër, Komisioneri rekomandon që, lidhur me këtë pretendim, ankuesi të depozitojë kërkesëpadi për konstatim diskriminimi, për shkakun e pretenduar, pranë gjykatës kompetente, pasi ndodhet brenda afateve ligjore të parashikuara nga neni 36, pika 1, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”<sup>5</sup>.

2. Pretendimi i dytë i ankuesit konsiston në diskriminim, për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë, nga ana e Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit.

Lidhur me këtë pretendim të parashtruar nga Z.A. H., Komisioneri gjykon se në kushtet kur, bëhet fjalë për konstatimin e diskriminimit të tërthortë, të një dispozite, të një akti nënligjor, i cili prek jo vetëm ankuesin, por edhe shumë individë të tjerë në pozita të njëjta apo të ngjashme me ankuesin, do të merret në konsideratë mundësia, që çështja në fjalë të shqyrtohet ex-officio.

---

<sup>5</sup> Neni 36, pika 1, e ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” parashikon: “*Padia i paraqitet gjykatës kompetente nga një prej subjekteve të parashikuara në nenin 34 të këtij ligji jo më vonë se 5 vjet nga dita që ka ndodhur sjellja e pretenduar diskriminuese dhe jo më vonë se 3 vjet nga dita që i dëmtuari merr dijani për këtë sjellje.*”

## **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenet 7, 17-19, 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), nenin 33, pika 4, gërma dh), si dhe në nenin 36, pika 1, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës nr. 71, datë 20.06.2019, e Z. A. H., pasi ankesa e tij është depozituar tej afateve ligjore, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Robert GAJDA**

---

**KOMISIONERI**

Fusha – arsim

Shkak - “mosha” dhe “përkatësia në një grup të veçantë”